

BASHKIA KAVAJË
NJOFTIM ANULLIMI PËR DHËNIEN ME QIRA

1. Autoriteti Qiradhënës: Bashkia Kavajë
Adresa: Rruga “Josif Budo”, Ndërtesa Nr. 10,
Email: ëëë.kadastra.bashkiakavaje@gmail.com
Tel: 055245555
2. Lloji i procedurës: “procedurë e hapur konkurimi publik”
3. Numri i Buletinit: Buletini nr. 34 datë 07.07.2025
4. Objekti i kontratës: “Për dhënie me qira të pasurisë me nr. nr. 458/3 vol. 2 faqe 64 e llojit “pemëtores” me sip. 21870 m², Z.K. 3939 Zikularaj, Njësia Administrative Helmas”,
5. Vlera dysheme për detyrimin e qirase: 10000 (dhjetëmijë) lekë/ha për një vit kalendarik.
6. Arsytet e Anulimit:
Bazuar në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 98, pika 1, gërma b:

Anullohet procedura e konkurimit publik “Për dhënie me qira të pasurisë me nr. 458/3 vol. 2 faqe 64 e llojit “pemëtores” me sip. 21870 m², Z.K. 3939 Zikularaj, Njësia Administrative Helmas”, për shkak se nuk është ofruar asnjë ofertë e përshtatshme.
7. Informacione shtesë:

BASHKIA FIER
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 54 dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 68 dt. 23.06.2025 “Për miratimin e fillimit të procedurave për dhënie me qira të sipërfaqjeve “tokë pa frut” të ndodhura në fshatin Fushë Njësia Administrative Topojë Bashkia Fier”, Bashkia Fier do të realizojë procedurën për dhënie me qira me konkurim të pasurive nr. 102/3 zk. 1655 me sipërfaqje 34 800 m² “tokë pa frut”; pasuria nr. 67/7 zk. 1655 me sipërfaqje 47 000 m² “tokë pa frut”; pasuria nr. 66/10 zk. 1655 me sipërfaqje 16 570 m² “tokë pa frut”; pasuria nr. 66/15 zk. 1655 me sipërfaqje 1 030 m² “tokë pa frut”;

pasuria nr. 66/13 zk. 1655 me sipërfaqje 400 m² “tokë pa frut”; pasuria nr. 102/9 zk. 1655 me sipërfaqje 14 000 m² “tokë pa frut” dhe pasuria nr. 102/11 zk. 1655 me sipërfaqje 46 200 m² “tokë pa frut”, të ndodhura në fshatin Fushë Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, prona të Bashkisë Fier.

Dhënia me qira e pasurive jepet me ushtrimin e aktivitetit në fusha të ndryshme sipas përcaktimeve të VKM nr. 54 dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Vlera dysHEME për detyrimin e qirasë për fillimin e ankandit do të jetë 27000 lekë ha/vit.

Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie është deri 20 vjet.

Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikët si vijon:

a) Niveli i investimit	10 pikë
b) Niveli i punësimit	10 pikë
c) Përvoja në fushën e aktivitetit që do të ushtrohet	10 pikë
d) Oferta e detyrimit mujor të qirasë	70 pikë

Konkurimi do të zhvillohet në dt. 10.10.2025 ora 11.00 në Bashkinë Fier sipas procedurave të parashikuara në VKM nr. 54 dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Në ngarkim të “Qiramarrësit” janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira sipas legjislacionit në fuqi.

Konkurentët do të paraqesin pranë Zyrës së Arkiv/Protokollit në Bashkinë Fier, deri në dt. 10.10.2025 ora 11.00 dokumentacionin si vijon:

- Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksion të objektit, ku të përshkruhen qartë; plani i punësimit, plani i investimeve si dhe treguesit që do të realizohen;
- Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Çertifikatën e regjistrimit dhe çertifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;
- NUIS – in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.